



“FUQIZIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI”

Trajnim: Cikli i Menaxhimit të Projektit

25 gusht 2021

Objektivi dhe progami



Objektivi

Mbështetja e OSHC-ve mjedisore për të rritur kapacitetet e tyre në përfitimin e menaxhimin e granteve (projekteve), si dhe rritjen e aftësisë së tyre për të adresuar në mënyrë efikase çështjet mjedisore lokale të cilat janë ngritur nga komuniteti apo ata vetë.

Programi:

Tema 1: Rrjeti dhe rrjetëzimi

Tema 2: Partneriteti

Tema 3: Projekte potenciale, rajoni qendror

Tema 4: Menaxhimi i ciklit të projektit

Tema 5: Konkluzione

Cfarë është rrjeti (network)?

Rrjetëzimi është **niveli më informal** i punës së partneritetit dhe përfshin **shkëmbimin e informacionit** për përfitim reciprok. Ka një **nivel minimal besimi** dhe **gatishmërie për të shkëmbyer** informacion dhe **kontaktet** zakonisht bëhen jozyrtarisht, kryesisht **nga personi në person** më tepër sesa nga organizata në organizatë.

Rrjetëzimi është **shkëmbimi i informacionit** dhe **ideve** midis **njerëzve** me një profesion të përbashkët ose interes të veçantë, zakonisht në një mjedis shoqëror **joformal**. Rrjetëzimi shpesh fillon me një pikë të vetme të përbashkët.

Mënyrat e rrjetëzimit



1. Fillo bisedën i pari:

- prezanto veten tek të tjerët
- ofroni dicka: mendim, dëshirë për bashkëpunim etj
- ndërvepro me personin/personat që ke përballë

2. Kërko nga kolegët, të njohurit, pedagogët të të prezantojnë tek persona të tjerë;

3. Përdor rrjetet sociale, përtej FB dhe IG edhe LinkedIn;

4. Merr pjesë në trajnime apo konferenca me tematika të ndryshme.

Përse është i rëndësishëm rrjeti?

Cilat janë benefitet e rrjetit/rrjetëzimit



Rrjetëzimi ka një **efekt amplifikues**. Amplifikim në këtë kontekst do të thotë që efekti i problematikës së ngritur nga një grup njërëzish, organizatash është më i lartë sesa një problematikë e gritur disa herë nga një individ apo organizatë.

Rrjetëzimi është një mjet për të siguruar një **bashkëpunim** më të madh **kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar** i cili mund të forcojë ndikimin e aktiviteteve të kryera nga organizatat me bazë komunitare.




Cilat janë benefitet e rrjetit/rrjetëzimit



Rrjetet janë një mekanizëm i fuqishëm për:

- ndarjen e informacionit dhe njohurive;
- promovimin e komunikimit;
- vepronë si katalizatorë efektivë për ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet aktorëve publikë, privatë dhe civilë;
- promovimin e koordinimit në nivel lokal, rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- ndërtimin e marrëdhënieve të besimit;
- shërbejnë si mekanizma të mësimit reciprok dhe ngritjes së kapaciteteve;
- ndërlidhjen e disa palëve të interesuara së bashku.



Rrjeti informal

Rrjetet e praktikës zhvillohen kur organizatat/njerëzit bëhen sëbashku në mënyrë vullnetare. Këto rrjete janë të përcaktuara nga **njohuria dhe përvoja** dhe jo nga një detyrë specifike e cila ka një afat kohor për tu përmbushur.

Rrjetet e sociale janë marrdhënie personale, miqësore ose të biznesit të cilat janë joformale dhe mund të zhvillohen ndërmjet profesionistëve dhe miqve. Këto rrjete nuk kanë një qëllim të përcaktuar dhe ato rriten në mënyrë organike. Këto rrjete mund të kenë qëllime rekreative, informuese etj.

Rrjeti formal

Krijohen nga individë, institutute apo organizata të pavaruara të krijuara për të **adresuar një ose disa problematika** në varësi të qëllimit të tyre.


Anëtarët kryejnë një sërë aktivitete të dakordësuara dhe takohen rregullisht me njëri tjetrin. Në përgjithësi rrjetet formale kanë një **rregullore/statut** i cili paraqet qëllimin dhe detyrimin e anëtarëve të rrjetit ku në varësi të dakordësisë mund të ketë nevojë edhe për një abonim.

Rrjetet formale mund të kenë në përbërjen e tyre OSHC, institucione qeveritare, agjenci zhvillimi dhe palë të tjera interesi në nivel rajonal apo ndërkombëtar.


Pyetje?

Cfarë është Partneriteti?


“ ... Partneriteti është një **bashkëpunim ndër-sektorial** në të cilin organizatat **punojnë së bashku** në një mënyrë **transparente, të barabartë** dhe në mënyrë **reciprokisht të dobishme**. Partnerët bien dakord të angazhojnë burimet, ndajnë rreziqet si dhe përfitimet për të punuar së bashku drejt një qëllimi të zhvillimit të qëndrueshëm.



Barazi/Equity sepse të çon në **Respekt**: për vlerën e shtuar që secila palë sjell



Transparencë sepse të çon tek **Besimi**: me partnerë më të gatshëm për të qenë inovativ dhe për të marrë rreziqe



Përfitim i ndërsjelltë sepse çon në **Angazhim**: më shumë gjasa për të ruajtur dhe ndërtuar marrëdhënie me kalimin e kohës.

Cfarë e bën një partner të mirë?



- Dikush që kërkon që partneriteti të jetë i suksesshëm;
- Kërkon zgjidhje të favorshme për të gjitha palët;
- Është i hapur dhe i qartë për qëllimet personale dhe të partneritetit;
- Është i hapur të dëgjoj mendimet ndryshe;
- Ka integritet dhe vepron në mënyrë të tillë;
- Përmbush detyrat e tij;
- Nuk i bën bisht detyrimeve të tij;
- Është i gatshëm të jetë fleksibël.

Përse krijohen partneritetet?


Arsyet mund të jenë të shumta, por disa prej tyre janë:

- **Reciprociteti** në ndjekjen e qëllimeve të përbashkëta;
- **Efikasitet** më i lartë në arritjen e qëllimit;
- **Qëndrueshmëri** më e lartë në kapërcimin e rreziqeve/pasigurive;
- **Legjitimitet** i cili rrit reputacionin e orgnizatave partnere;
- **Nevoja** për të adresuar një problematikë a fenomen.



Organizatat mund të përfaqësohen si tre qarqe të ndërlidhura ekzistuese brenda një konteksti më të gjerë:

- Rrethi '**Për të bërë**' përfaqëson aktivitetet e programit që organizata realizon dhe aftësinë e saj për të arritur qëllimet e saj.
- Rrethi '**Për t'u lidhur**' paraqet lidhjet e jashtme të organizatës me aktorë të tjerë në sektorin publik, privat dhe shoqëri civile.
- Rrethi '**Të jesh**' përfaqëson funksionimin e brendshëm të organizatës.



Element të partneritetit



Element të rëndësishëm të partneritetit janë:



Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm të partneritetit



Formalizimi i marrdhënies;



Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve;



Kohëzgjatja.

Të drejtat dhe obligimet



Fokusi	Detyrimet	Të drejtat
Informacioni	Të mbahet një komunikim i vazhdueshëm	Për të gjitha informacionet që lidhen me nismën
Konsultimi	Të mos modifikohen komponentë të projektit apo partneritetit pa marrëveshje reciproke.	Të zhvillohen konsulta përpara se të kryhen ndryshime në marrëveshje apo projekt.
Dakordësimi i planit të punës	Të pranohet ndarja e barabartë e detyrave	E drejta për të ndikuar në ndryshimin e planit të punës
Kontrolli	Angazhimi në bashkëmenaxhimin e partneritetit projektit	Bashkëmenaxhimi i aktiviteteve.
Kohëzgjatja	Angazhimi i duhur i burimeve njerëzore dhe financiare për të gjithë kohëzgjatjen e projektit	Vazhdimësia e dhënies së kontributit nga anëtarët e tjerë.

Skenari: Një bashki në Shqipëri me papunësi të lartë, deficit në ofrimin e shërbimeve publike, shkallë të ulët në adresimin e problematikave sociale dhe të ardhura të pakta për ti adresuar ato.

Shqetësimi i kryetarit të bashkisë	<ul style="list-style-type: none">- Buxheti është i vogël për të zgjidhur problematikat;- OSHC dhe media janë kritike ndaj punës së bashkisë;- Personeli i bashkisë është i demoralizuar.
Qëllimi i kryetarit	<ul style="list-style-type: none">- Të mbajë premtimet elektorale, të pastrojë qytetin dhe të rrisi të ardhurat;- Të krijojë një klimë të mirë për të tërhequr investitorë.
Shqetësimi i OSHC-ve	<ul style="list-style-type: none">- Kontributi që ata po japin në përmirësimin e situatës nuk vlerësohet nga bashkia.
Qëllimi i OSHC-ve	<ul style="list-style-type: none">- Të adresojë problematikat lidhur me papunësinë e të rinjve;- Të përmirësojë cilësinë e shërbimit për menaxhimin e mbetjeve dhe parqeve;- Të zhvilloj aktivitete për të nxitur punësimin në shkallë të vogël.

Qasja:

Zhvillimin e aftësive më të mira

Zgjerimi i bazës së përvojës

Mendimi/veprimi strategjik

Përgjigju mirë vështirësive

Ndryshoni sjelljen tuaj

Ndërtoni besueshmëri

Sugjerim:

Përdorni një gjuhë tolerante, përpiquni të qetësoni e jo përkeqësoni një situatë;

Nëse nuk keni eksperiencë në një çështje kërkoni partner;

Nëse hasni një pengesë, merrni pak kohë analizoni ftohtë atë, pyesni një koleg;

Ruani objektivitetin edhe në rast vështirësie;

Shihni mundësinë se çfarë mund të bëni ndryshe;

Provoni vendosmërinë dhe gjykimin tuaj korrekt me kalimin e kohës.

Check list per një partneritet të suksesshëm



- Zgjidhni çështje unifikuese: partneritetet e sukseshme kanë në fokus çështje të përbashkëta;
- Kuptoni dhe respektoni interesat e çdo anëtari;
- Respektoni mendimin ndryshe;
- Jo gjithmon do të jeni dakord (agree to disagree), por vendosni mekanizma të cilat ju lejojnë të merrni një vendim;
- Vendosni me kujdes: ruani balancat;
- Njihni kontributin e të gjithëve, shpërndani meritat.
- Jepni dhe merrni: ndërtoni një partneritet ku shkëmbehet informacion nga dhe me të gjitha palët;
- Bëhuni strategjik: ku mund të kërkoni informacion, ndihmë, kë përfshini në partneritet;
- Jini të qendrueshëm, qëndrojeni deri në fund angazhimit që keni marrë.

Rreziqet për një partneritet



- Problematika që po trajtoni mund të kthehet në një çështje që ju merr vëmëndjen nga problematikat e tjera;
- Partneriteti mund të jetë më i dobët seç mendoni, kështu që mundohuni të ruani ekuilibrin;
- Partnerët mund të kenë mendime të ndryshme për taktikat që duhen ndjekur;
- Konfliktete mund të lindin mbi shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave.

Të ndërtosh një partneritet kërkon



- Kohë të kuptojmë të tjerët;
- Punë paraprake;
- Angazhim të plotë;
- Njohja e pikave të forta dhe të dobësive të partnerit;
- Ruajtja e transparencës;
- Respekti reciprok;
- Mbështetje reciproke;
- Ndryshim i roleve;
- Shijoni punën në grup.

Faleminderit! Pyetje?

Projekte potenziale për Rajonin Qendror

Problematikat kryesore mjedisore sipas Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) dhe VSM-ve:

- i. Nivele të larta të ndotjes së ajrit në zona urbane;
- ii. Humbje dhe reduktim të hapësirave të gjelbra publike;
- iii. Degradim të tokave bujqësore;
- iv. Menaxhimi i mbetjeve;
- v. Ndotje të trupave ujorë.

Çeshtjet mjedisore të ngritura gjatë procesit të Vlerësimit të Nevojave:

- i. Ndërgjegjësim mjedisor;
- ii. Mbrojtje e ripërtëritje të burimeve natyrore;
- iii. Menaxhim të mbetjeve dhe Ndotje Urbane;
- iv. Ndryshime klimatike;
- v. Mobilitet dhe Ekonomi Qarkulluese.

Qarku Durrës

- **Problematika mjedisore:** Ndotja e zonës bregdetare nga ujërat e ndotur

Projekti potencial: Monitorimi, vlerësimi dhe i ndotjes së vijës bregdetare XXXX

Vizita në terren,
fotografimi i gjendjes
ekzistuese

Hartëzimi i
informacionit

Pajisja me sinjalistikë
informuese për zonat
me rrezik të lartë
ndotjeje

- **Problematika mjedisore:** Reduktimi i hapësirave të gjelbra publike si pasojë e urbanizimit

Projekti potencial: Evidentimi i xhepave urbanë për t'u kthyer në zona të mirëfillta të gjelbra publike

Vlerësimi i gjendjes
ekzistuese

Evidentimi i hapësirave
potenciale për t'u
rivitalizuar

Pajisja me elementët e
nevojshëm urban &
mjedisor

Projekte potenciale për Rajonin Qendror



Qarku Fier

- **Problematika mjedisore:** Prerja e pyjeve dhe presioni në rritje në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta për shkak të zhvillimit urban dhe bujqësisë

Projekti potencial: Promovimi i peizazhit natyror dhe ruajtja e biodiversitetit

Ndërgjegjësim mjedisor

Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit

Projekte potenziale për Rajonin Qendror



Qarku Elbasan

- **Problematika mjedisore:** Mungesa e ndriçimit publik në ambiente/akse publike

Projekti potencial: Ndriçimi i ambienteve/akseve publike në zonën XXX

Evidentimi i zonave me mungesë të ndriçimit publik

Pajisja me elementët e ndriçimit publik

Ndërgjegjësim mjedisor

Projekte të tjera:

- Monitorimi i buxhetit vendor për shërbimet mjedisore;
- Ofrimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve & investime konkrete;
- Monitorimi i ndotjes së ajrit dhe ndotjes akustike në zona urbane;
- Vlerësimi i flotës aktuale të mjeteve të transportit publik dhe ndotja potenciale që ato shkaktojnë në mjedis;
- Ndikimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në sistemin urban dhe në burime natyrore
- Etj.

Faleminderit! Pyetje?
